



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT
Komiteti për Politikë dhe Financa
Më: 24 qershor 2026

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nga mbledhja e jashtëzakonshme Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 24 qershor 2026 (e mërkurë) në sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:00.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Simir Krasniqi, Kryesues i KPF-së, Arianit Berisha, Ymran Fusha, Trëndelina Kastrati, Dafina Alishani, Ilir Gashi, Haziz Hodaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj dhe Shukri Quni, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Nënkryetari i Komunës z. Kujtim Gashi, Levent Bus – drejtori i drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, Lulzim Sylejmani zyrtar nga drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Dafina Krasniqi – Asistente e Kryesuesit të Kuvendit, dhe përfaqësues nga shoqëria civile dhe mediat lokale.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përshëndetje të pranishëm, përshëndetje anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, i nderuar nënkryetar i komunës, zotri Kujtim Gashi, i nderuar drejtor i ekonomisë dhe financave, i nderuar zyrtari kryesor financiar. Konstatoj se të pranishëm jemi 8 anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe kemi kuorum të mjaftueshëm për hapjen dhe zhvillimin e mbledjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa. Pas kërkesës së kryetarit për caktimin e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit me një pikë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitet 2027-2029.

Njëkohësisht unë si kryesues i kuvendit kam thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme të Komitetit për politikë dhe financa për të shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës dhe për t'ia rekomanduar Kuvendit për procedurat e mëtutjeshme për shqyrtim dhe miratimin e kësaj pike. Materialin e keni marrë me kohë për këtë pikë dhe pa humbur kohë pra i'a japim fjalën nënkryetarit të komunës apo drejtorit për ekonomi dhe financa apo zyrtarit financiarë, si të dakordoheni ju të dytë, se cili doni. Atëherë fjala për ju Lulzim Sylejmani.

Lulzim Sylejmani: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pas pranimi të Qarkores së parë buxhetore 2027 për ne, ne kemi filluar përgatitjen e KAB-it për buxhetin e vitit 2027, faktikisht parashikimin për vitin 2028-2029. Në bazë të qarkorës që ne kemi pranuar, kemi nxjerrë që buxheti i vitit 2027 për komunën e Prizrenit do të jetë 79.118.941€ i shpërndarë nëpër kategori ekonomike, sipas propozim vendimit të cilin e kemi marrë materialin, paga dhe medijtje do të jenë 32.534,278€, subvencione 5.713.495, mallra dhe shërbime 15.730,224, shpenzime komunale 1.405299, investime kapitale 23,735,681 €. Te investimet kapitale e kemi një pjesë që është kredi për efikasitet të energjisë që sa vite u sill nëpër buxhete dhe po më duket do t'i vjen rendi me e shfrytëzuar tash pas heqjes së sanksioneve që i kemi pasur nga BE-ja dhe kjo është buxhetuar si 2 milion te investimet kapitale që është për rinovimin e objekteve, shkollave, ndërtesave që i menaxhon komuna, do të thotë total buxheti për vitin 2027 është 79,118.941€. Gjatë përgatitjes së buxhetit, po mendoj kornizës afatmesme buxhetore ka qenë goxha sfidë, sfidë është përfshirja e obligimeve të cilat i kemi për kontratat e lidhura, dhe ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjësive na obligon që para çdo propozimi të ri, të buxhetohen obligimet kontraktuale të cilat janë obligime të lidhura nëpër drejtori të caktuar si në kapitale, në mallra dhe shërbime të tjera. Kështu që në listën e kapitaleve të kemi parasysh që të gjitha kontratat e lidhura janë buxhetuar nëpër drejtori, sepse është obligim ligjor, nuk mundesh me qitë propozime të reja jashtë obligimeve, nëse ne kemi hapësirë buxhetore atëherë jashtë obligimeve do t'i buxhetojmë edhe kërkesat e reja që do të vijnë nga dëgjimet publike deri në fillim të shtatorit, të cilat dëgjimet do t'i mbajmë në muaj të mbledhjeve. Ajo që thashë, domethënë është obligative buxheti i kontratave dhe obligimeve të kontraktuara të cilat janë të lidhur deri tash. Siç e dini, domethënë gjatë këtyre viteve janë bërë shumë ekzekutime nga përmblyesit dhe ajo na ka shkaktuar shumë telashe se nëse ne sot kur po flasim për vitin 2022 dhe deri në këto momente prej vitit 2022 dhe deri në këto momente që po flasim janë diku rreth 36 milion euro të ekzekutim, po flasim për kontrata të cilat janë të lidhura ndër vite por të cilat skanë mundur me u ekzekutu si pagesa ose si realizime në terren për shkak të ekzekutimeve. Ne gjatë vitit të kaluar i kemi buxhetuar kontratat për me i kryer punë sivjet, sivjet janë marrë deri tash domethënë 15 milion euro janë marrë tash prapë kontratat e njëjta kanë mbet pa buxhet dhe të cilat nuk mund me realizu. Kështu që e kemi obligative t'i buxhetojmë dhe t'i përcjellim për në vitin 2027. Për fillim nuk kisha pas çka me shtu më shumë, ndërkohë jemi këtu, bashkarisht do të mundohem ta bëjmë më të mirën të mundshëm me këto që i kemi, faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Lulzim, atëherë e hapim debatin, kush do ta marrë fjalën, po fjala për ju Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesues, ju përshëndes të gjithëve, sinqerisht nuk po di ku me ja nis, ne jemi të vetëdijshëm për gjendjen financiare në Komunë si pasojë e kontratave kolektive të projekteve që janë janë zhvilluar, janë në zhvillim e sipër nuk janë paguar dhe ato tash ju marrin paret me përmblyes. Mirëpo, kjo është një paralajmërim i keq që realisht na kemi pas gjendjen edhe në vitin 2027 të njëjtën, sepse po që se nuk arrijmë bile deri në fund të vitit me ardhë në zero, nuk e di mandej qysh kemi me ja nis zhvillimit të realizimit të projekteve në vitin 2027. Kam thënë

edhe disa herë përpara po e them edhe sot edhe kjo është korniza afatmesme buxhetore dhe duhet me u kaluar, duhet me u votu, sepse është kornizë orientuese. Mirëpo po ju them juve drejtorit të financave dhe ty përfaqësues zyrtarit të lartë për financa, po ju lus që në hartimin e projektit për vitin 2027 mos të jenë qesi pozicione buxhetore që realisht janë fontanë dëshirash dhe plotësim dëshirash, njëherë dëshirë e juaja, por mandej edhe plotësim dëshirash të qytetarëve dhe kjo është që këto munden mos me u realizu asnjëra prej tyre. Me një pozicion buxhetor po e zëm numër dy janë 25 lokalitete që përfshihen investime me 400.000-500,000€ me 600.000€ me 800.000€ kjo është po ju them paralajmërimi i keq që të njëjtin problem ne kemi me pas edhe vitin e ardhshëm sa i përket financave publike. Dhe nëse nuk i parashohim nëse nuk i kryejmë do obligime brenda vitit dhe nuk i parashohim projektet konkrete për vitin 2027, sigurisht që duhet me pritë në vend. Tash nuk e kemi guximin jo ne si përfaqësues sigurisht që jemi këtu, me kërku një investim qoftë edhe simbolik diku sepse përgjigja e parë prej gjitha instancave është nuk ka pare! Dhe çka këtu çka mandej! Kështu që ju tham kini kujdes në hartimin e e buxhetit ai ka me kalu edhe nëpër edhe nëpër debate publike, edhe nëpër dëgjime publike, në lokalitete, në qytet, por është mirë njëherë e përgjithmonë, t'i iket kësaj formës përgjithësume, po të parashihen në buxhet projektet konkrete që bile bile i afrohen kalojnë mbi 50% e realizimit mandej gjatë vitit. Përndryshe e krijojmë veç një kaos financiar, mandej kaosi financiar i sjell edhe kaose të tjera, për fillim kaq, faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, vazhdojmë, po fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues, përshëndetje kolegë të komitetit për politikë dhe financa, media, drejtor. Përsa i përket kornizës afatmesme buxhetore, po e kemi shikuar të gjithë edhe ju, unë nuk pashë diçka që ka me pas, po flas gjithnjë nga kjo pjesë ka vij unë, ata të tjerë të cilët i kanë përfshi ato pjesët e tyre ka vijnë ata, ata munden veç me ja bë.. se edhe kolegu tha duhet me votu ai, Hazizi mundet me ju thënë me votu vetëm qka i ka kta të partisë së vet, të tjerët janë secili vendosë për partinë e vet.

Haziz Hodaj (LDK): Sigurisht jo, nuk ju obligova juve.

Shukri Quni (BDP): Por jo, kur bëj ftesë me votu kam dëshirë me ju përgjigj asaj, që ju lutem me votu ose mos me votu. Unë nuk do ta votoj Haziz, sepse nuk janë përfshir këto fshatra të cilat unë i përfaqësoj, edhe ti vjen nga ajo ana po ti i ke si të ndara diqysh. Mazareku s'u përfshih hiç, Kojushë jo, Pllaneja hiç, Gorozhupi ashtu. Nasheci është përfshi në mënyrë kështu sipërfaqësore, nuk ka kod buxhetor, s'ka pare të ndame, a janë borxh këta, a i'a merr përmbarues, mu nuk është duke më interesu si asambleist, unë si kuvendar jam ai i cili përfaqësoj interesat e qytetarëve, këta janë ata që duhet me ruajt paren e qytetarit, këtë duhet me ditë. Edhe nuk është përmbaruesi që ju ka marrë tyre që katër vjet, po vetëm që ky vit që kaloi ka marrë, edhe nuk e di unë për qka tash çdo send me u lidhë me përmbaruesin, po ta jap një shembull konkret, unë reagova në mbledhjen e fundit për manifestimin java Remzi Ademaj që mbahet që 24 vite. U qu drejtoresha sikur ish drejtoresha e turizmit kur ia pat bërë atë Xhavit Ukës, qashtu edhe unë ma ka bë, as s'më dha përgjigje, po u çu nënkryetari dha përgjigje edhe u realizua, qeshtu tha janë edhe inqizimet do të realizohet edhe u realizu, ku po gjenden ato mjete. Unë asnjëherë nuk e kam mbrojtë të fortin,

kushdo që ka qenë në pushtet s'kam ndij për të hiç, ama s'ndi apet nuk ndi për asnjë, se s'jam i nvarur prej asnjërit, po jam për ata qytetarë që kam ardhë me i mbrojt këto interesat e tyre, ata më kanë pru këtu, se unë për disa edhe kufirin na kishin vu, tash ka ardhur qyteti ka ardhur deri te ne i thom deri në saratllak atje kush e merr vesh Kujtimi e din ku është sarakllaku, deri te autostrada ku kalon ura autostradës për Nashec qaty ta venë kufinin. Ty ta kishin vu me kanë në dushkabek s'kishin lënë me hy hiç. Unë sa herë e kam ngrit një çështje për me u rregullu një kanalizim rruga Besim Shala, më duket ju kam lodh me atë rrugën tash rruga Nashecit tash thirret rruga heroi Besim Shala. Haziz aty derdhën gropat septike prej oborrit derdhet në asfalt aty, vjen era..., atë rrugë e kemi mbaruar ne në kohën e Eqerem Kryeziut 104.000 euro kemi qit kemi participuar atëherë është mbaruar rruga e Nashesit, rruga e Amaxhës prej rrethit e din Kujtimi deri te shkolla bile as mrenda në katund s'pat hy, rruga Lybeqevës edhe rruga Gjonaj qatë kohë janë ndërtu, me participim e kemi pas. Shumë kujt aq po i djeg se unë po e ngrej këtë çështje, o zotni kam paguar 2000 euro në atë vakt, unë si familje. Ka qenë vështirë me i mbledhë në atë kohë 104.000 sa sot ma merr mendja 1.400.000 euro kushtojnë, se nafti ka qenë 62 cent kur është shtru rruga e Nashecit 60-62 cent ta jep me argument thonë ku po e din, e di se kam pas punë atëherë se i ma një arkiv të mirë. E sot të bëhet ajo rrugë në nivel me ardhë në shekullin 21 këtë temperaturë 35-6° sa është, të mbytë era aty sun kalon. E dyta sa herë e ngrej atë çështje qysh bre me u pre asfalti për çdo ditë, nuk e di unë kujt po i flas unë në atë asamble qysh me u pre a për inat janë tu e bë ata? Janë gjëra të cilat i kam ngrit si çështje i kam bë kolege me shkrim, a e ke parë që ti dërgova unë kurrë nuk flas për menq të gjitha çfarë kam kërkuar në asamble t'i kam dërguar thashë qe edhe unë po i dërgoj thashë në kuvend komunal thashë po spo i marrim parasysht. Du me e lidh pak edhe një çështje kur ka qenë kryetar Eqerem Kryeziu është shtru rruga Nashec-Prizren Hazizi nuk e di a ka qenë, unë e kam prit Eqerem Kryeziun me mish e me pite me tupana, bile ma merr mendja që Qazim Thaçi sa të ditë ta përzieva mbiemrin, ka qenë kur është bërë inaugurimi i asaj rruge. Te unë nuk dallon kryetari kush është shumë. Mos të largohemi prej kësaj teme nuk ka hy në projekt kjo, drejtor ajo rrugë duhet me u rregullu, i kam thënë Sulltan Badallajt, ma ke borxh një trap të kerrit, tash po i them Islam Ukimerit edhe ty po të them unë, nuk kam pare me rregullu për ditë sa herë ta presin asfaltin ata ndani buxhet edhe le të mbushen ato gropa, na mbaruam o burrë hypi kerrit shko këqyre çka bëhet, s'është nda buxhet për të këto kërkesa i kam ngrit si çështje. Pastaj, e kam kërku s'di sa herë ka qenë edhe në buxhet, prej buxheti për impiantin në fshatin Nashec edhe Tupec në fusha ku lidhen të dy fshatrat, ujërat e zeza prej këtu në shtëpinë e bardhë që shkonë ramja andej nga Arbana, nga Petrova, poshtë, lagja Jeta e Re, Ortakolli, krejt shkojnë dredhen në Nashec edhe emisione kemi bë, bile do kandidatë që kanë kandiduar për kryetar, vinin bënin fushatë aty dhe më kurrë s'kanë ardhë. Ne jemi në zor prej kanalizimit, pse mu heqë hartimi i projektit, s'po kërkojmë ne me bë menjëherë le të bëhet njëherë projekti se ka vende që ndihmojnë këtë në këtë drejtim edhe këtë kërkoj me hy kjo me u hartu projekti. E bëra një kërkesë edhe në asamble e ngrita si çështje, në Mazrek ekziston një gurrë e din Haziz Hodaj kanë pi ujë Mazreki, Kojushi thash pijnë ujë të Nashecit se ne i çojmë ujë, krejt pinë. Kërkova me bërë një rezervuar, ajo gurrë buron, verë dhe dimën, prej shtatori deri në mars s'ka nevojë ata me përdor ujë tjetër pos aty edhe me rëmje të lirë vjen se është përmijë nalt, edhe ajo nuk ka hy fare në buxhet, me një projekt shumë, pak shumë

pare shkojnë, a punë e madhe kryhet se uji Nashecit është ujë i shtrenjtë me tre pumpa ju çon ujë atyre, në Nashec është një, në Kojush është një edhe një përmbi Kojush që e shpërndan ujin, ai është i shtrenjtë shumë kokakoll me pi është më i lirë sesa atë ujë me pi. Kam bërë kërkesë edhe nuk ka hy fare, rruga që e lidh Nashecën me Tupec është një nga 900 metra rrugë me kubëza po kur është ndërtuar rruga Landovicë edhe Arbanë që janë ndërtu katër trakshit me Podrime me Has kanë ardhë qasaj rrugës, kamionat më të rëndë edhe e kanë deformu atë, një pjesë është asfalt nëpër Tupec që del e shkon për Has për Podrime nga 900 metra duhet me u rregullu ajo, s'mundesh me kalu aty edhe kjo nuk ka hy fare. Plus rruga prej Nashecit te ura Nashecit është pak edhe ja 2 km është me ju qit edhe asaj një shtresë, ajo vitin e ardhëm bëhet llam ka sepse është shtru kur është shtru rruga Vlashnje Kobaj edhe kjo është shtru atëher, po aty e rregulluan për fat e kjo mbet. Po du me thënë që me e mbrojt, është lehtë me e bërë po është shumë vështirë me e ruajt edhe me e mbrojt unë e kam qejf ato që i kemi punu me i ruajt. Pastaj kam bërë edhe kërkesë për një sallë të sportit ne jse për atë duhet me qenë edhe drejtorat këtu...

Simir Krasniqi (Kryesues): Në kuvend edhe shumicën e diskutojmë.

Shukri Quni (BDP): Po këtu duhet me fol diçka ose mos na thirr hiç nëse doni mbledhje shpejt e shpejt, ja ku i keni votat, unë s'vi edhe u kry muhabeti.

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo e thashë që drejtorë të tjerë të dikastereve i ke në kuvend aty të kulturës e të tjerë.

Shukri Quni (BDP): Më duket i thashë edhe unë thashë që për këto s'je edhe e ndërprejta, vazhdoni se e kryeta, faleminderit.

Haziz Hodaj (LDK): Jo, veç diçka se më përmendi disa herë sikur me pas hartu projekt buxhetin, dy minuta, e unë thashë edhe në fillim edhe unë nuk jam i kënaqur se qysh parashihet Mazreku dhe Kojusha parashihet edhe Gjonaj, domethënë në projekte të përgjithshme, se s'ka kurrgjë konkrete as për Gjonaj me gjithë kërkesat që i kam unë, i kam prej fillimit të mandatit të kaluar e kam kërkuar rrugën kryesore, këta kanë ardhë kanë bërë rrugë dytësore edhe ata me krejt infrastrukturën me vija të bardha nëpër lagje, e nëpër familje nuk e kanë bërë rrugën kryesore. Kjo e ka irritu masën edhe kudo flitet për këtë punë për rrugën kryesore me u lënë me u bërë rrugat dytësore rrugët familjare, kjo nuk ju bën mirë as juve as neve as kërkujt as mua personalisht që jam përfaqësues i i atij regjioni i atij fshati. Nuk është paraparë nuk e di çka jeni duke mendu si do me u kry kjo punë, thashë ky është projekt orientues për atë punë dhe duhet me kalu duhet me kaluar sepse na pret buxheti konkret për vitin 2027 atë duhet me pas kujdes kur i parashihni pozicionet buxhetore që me kanë konkrete me kenë të konkretizuar dhe me u dit çka mund me kry edhe me e pa gjendjen financiare reale që e keni dhe në bazë të asaj me i paraparë projektet. Ne nuk mundemi me i mbaru qefin vetit nuk ka, ti po thua që nuk ka këtu lokalitet që nuk është i përfshim në këtë kornizë, nuk ka lokalitet, mirëpo a kryen a s'kryhen kjo është pikëpyetje shumë e madhe, edhe jo që shumë pyetje e madhe po ja 70-80% nuk kryen po jam i sigurt.

Shukri Quni (BDP): Mbasi më përmende edhe ti mu kundër replikë, shiko kjo kornizë e buxhetit, vetëm 30% kemi të drejtë me ndërhy, ndash në debate ose në asamble, për atë unë reagoja se vetëm 30% ke të drejtë këtu.

Haziz Hodaj (LDK): 30% është sa të duash me e konkretizu.

Shukri Quni (BDP): More për mua 0003 nuk e ndryshojnë ata po unë po të them që për ata po duhet me reague se këta nuk e di unë me kënd po e bën projekt këtë kornizë nëse nuk konsultohet, për çka nuk na thirrin neve me u konsultu, me thënë hajde njëherë ju këtu çfarë projekti keni ju shefat e grupeve nga ato pjesë nga vini ju, këta po e bëjnë vetë. Ky po më thotë unë i kam votat u kry muhabeti, unë i kam votat tash e nga hajde kush është krejt i çojnë votat, unë dal kundra u kry puna hec perpara.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë vazhdojmë, fjala për ju Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit, ne çdo herë kur të vjen pika e kornizës afatmesme buxhetore gjithmonë arsyetohem që këto janë korniza, këto janë orientime, këto janë vetëm sa për sy e faqe, se prapë kemi me ndryshu, i marrin kërkesat e kuvendarëve. Tash unë e di çfarë ka me ndodhë edhe në kuvend, ka me u diskutu edhe në fund ka me u thënë me të gjitha rekomandimet e juaja po e fusim në votim, edhe kjo është me ja la trut secilit aty që është i gatshëm me dhënë votën se i paska premtuar nënkryetari apo kryetari që kanë me i pas parasysh. Mua po më vjen keq më së pari që qysh pranoni ju me qenë bashkë në koalicion edhe mos me pas, unë po e shoh çfarë dallimi keni më së pari nëpër drejtori, me qenë LDK-ja qysh po thotë paska kryp po s'paska kryp, ish dashur me e ngrit zërin me thënë drejtoritë tona po trajtohen si mos me qenë pjesë e qeverisjes. Pastaj janë disa pika që sinqerisht s'po muj me i kuptu, janë vendos si projekt të ri, po nuk ka buxhetim për këtë vit edhe vitin e ardhshëm, për shembull mua shumë po më intereson, po shpresoj që vjen kryetari me na tregu si ka mundësi me e fut prapë projektin nënkalinimin e BVI Bazhdarane, kur vetë në fushatë është deklaruar që ka qenë një premtim i gabuar, bile ka deklaratë që ka thënë që ne jemi tërheq prej këtij premtimi. Tash çka ka ndodh që po futet si kod buxhetor, nuk po e kuptoj, pastaj e ke ndërtimi i objektit të komunës, me gjasë qysh kam dëgjuar, planifikohet këtu në Bazhdarhane përballë qendrës sportive. Ndërkohë kemi buxhet tjetër te kultura që thotë te katër kullat aty do të bëhen terrene sportive, tash a po koncentroheni a po bëni komunë apo bëni terrene sportive se ajo hapësirë nuk besoj që ka mundësi me pas edhe terrene sportive edhe objekt komunal apo është prapë domethënë që një fontanë dëshirash që i keni futur pa analizë, që ndërtimi i fushës sportive te katër kullat, a e din unë nuk po e kuptoj qysh mundeni me i pas këto linja buxhetore pa një planifikim të duhur. Pastaj janë këtu disa linja buxhetore të cilat po dua me ditë edhe për këtë arsye ka shumë të drejtë zotëri Shukri Quni, që ish dashur me qenë edhe drejtor këtu që ne me i pyet për secilin dikaster, ka kode buxhetore shumë të përgjithësuara domethënë e keni me sa e di unë edhe kodi buxhetor edhe KABI edhe buxheti duhet me pas kode të specifikuara. Ka me u bë parku në filan lagje, ka me u bë terreni sportiv në filan lagje, ju i keni futur me një kod buxhetor rregullimi ambient të oborreve në shkollat e Prizrenit, cilat shkolla janë ato, rregullimi i rrugëve, e keni përgjithësu nja tetë lagje, a bën me specifiku ku është ajo, çka është, cila, çka keni me bë,

ose për shembull, parqe nuk e di njeri as ku ka aty hapësirë për me u bë një park edhe tash një asambleist i cili duhet me votu këtë KAB, nuk e ka idenë as ku është orientimi komunal edhe çfarë ka me votu. Ndërtimi i shtëpisë me bazë në komunitet, a mundeni me më treguar çfarë është plani i kësaj qysh e keni menduar, rregullimi i verandës dhe oborrit në shtëpinë rezidenciale nëse s'gaboju kjo është që tre vjet vjen si kod buxhetor, mua më kishte ardhë marre me prurje të kodit të njëjta që asnjë hap nuk është vendosur. Pastaj ka kodet buxhetore këtu që janë trevjeçare ndërkohë ne në terren shohim që nuk ka filluar ende, tash ju prapë arsyetoni që përmbaruesi, po është gjynah këtu me i fut sepse nuk ka me u realizu as kjo. Pastaj e keni kodin buxhetor të cilën jam tepër e interesuar me ditë, në shëndetësi, pajisje mjekësore 50.000€ veç për vitin e ardhëm, pajisje stomatologjike 0€, pajisje laboratorike 0€, ndërkohë drejtori i shëndetësisë na doli me reagim, na tha jemi shumë keq edhe nuk kemi me pas pajisje medicinale, pajisje jo medicinale janë planifikuar 100.000€. A është më prioritet pajisja medicinale për të cilën drejtori neve na tha që jemi në krizë, edhe nëse na merren edhe 1 milion euro ne nuk kemi me pas mundësi me dhënë shërbime, ndërkohë në planifikim nuk e ke. Tash dikush këtu është duke gënjy ose po tentojnë me bë propagandë politike ose nuk e di çka është puna. Ndërtimi i infrastrukturës në parkun ekonomik Lubizhdë, ju që keni lobu shumë edhe keni dalë me biznes e keni fol edhe që menaxheri i performancës ka premtuar që këtë vit ka me u aktivizu parku i biznesit, a e dini sa euro janë nda për vitin e ardhshëm ju që po mendoni me votu, 0 euro vitin tjetër 50.000€ çka mundem me bë për biznese ne me 50.000€ në zonën ekonomike? Ju që po na ftoni me thënë mirë është me votu ose kena me votu. Sinqerisht unë edhe juve ju kisha ftu me reflektu si LDK, sepse kjo çka ju po aludoni edhe po më vjen shumë keq se ju e nisni fjalinë bashkë me juve e kam problemin. Këta janë në pushtet ju e nisni fjalinë thoni shumë keq, nuk janë përfshi këto lagje pushkë gjuani për Has, Hasi kërka këtu po duhet me u votu. Këtë spo mundem me e kuptu, unë kam respekt të madh për ty se je ju jeni si lloj veteranë të kësaj pune.

Haziz Hodaj (LDK): Për Hasin ju duhet me lobu më shumë se unë, se ju keni marrë vota më shumë se ne, kështu që nuk ju nuk u kufizoj unë kërkesat për Has.

Dafina Alishani (LVV): Me bë me fol unë për Has në kuvend a e di çka bëni ju, ju e keni privatizu, janë tre veta që folin për Has me bë me fol dikush tjetër... unë e kam tentu.

Haziz Hodaj (LDK): Asnjëherë, Selmani ta ka privatizuar asnjëherë unë nuk kam reagu.

Dafina Alishani (LVV): S'është asesi e vërtetë unë e kam fol ju jeni çu dhe keni thënë për Has ka kush fol këtu urdhëro fol tash për Has. Se qeverisja jote që je bashk në qeverisje po ta diskriminon Hasin.

Haziz Hodaj (LDK): Këtu është i diskriminuar krejt qyteti po nuk jeni duke e parë, nuk është vetëm Hasi.

Dafina Alishani (LVV): Pse po e shoh edhe nuk po e votoj, por ju nuk keni guxim mos me e votu.

Haziz Hodaj (LDK): Guximin as s'ma merr kush as nuk ja jap kerkujt, por jan disa gjëra parimore që duhet me i pas parasysh se nuk mundemi me i blloku ne, nuk jemi bllokues, ajo është problemi.

Dafina Alishani (LVV): Jo dhe diçka, më fal edhe te teksti i dokumentit, nuk e di kush e paska shkrujt, po e shoh një farë koncentrimi, kështu që fort i paske përdor mundësi të barabarta për të gjithë, gratë, burrat, keni filluar aspektin gjinor tash me e shkruajt në dokumente, kurrë se kam pasur këtë qasje ndoshta keni vendos tash me u qenë pak më më sensitiv në çështjet gjinore, po në praktikë po më vjen keq që nuk jeni, për shembull këtu e keni përdorë, e keni përmend nënat lehona që do t'i keni prioritet. A e dini që nënat lehona sivjet s'kanë me marrë shtesa, a e dini që hiç s'ka me pas sivjet për nënat lehona pagesa, është keq me shkruaj diçka që nuk ka me mund me u realizu, ska me pasur pagesa drejtori është deklaruar në kuvend ka thënë që mbështetje për lehona nuk ka me pas, Fatmir Memaj. Thirrja nuk është bë aplikimet, nuk janë bë nuk ka pagesë.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): A ban pak kryesues?

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë fjalën e ka nënkrytari zoti Kujtim.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit shumë, jemi sigurisht para një dokumenti të rëndësishëm, që është pak më shumë orientues dhe duhet me pa në këtë kënd, po pak Dafina më nxiti me fol. E para duhet me pas parasysh që komuna nuk e trajton Hasin, Vrrinin, Potgurin, Përdrininë, Prizrenin si zona të veçanta, për shkak se Prizreni është një tërësi, edhe projektet shkojnë në bazë të prioritetëve të kërkesave të banorëve e para, e dyta normal që dhe ekzekutivi i ka prioritetet e veta aty ku e sheh që është më e rëndësishme me investu. Tjetra u fol këtu për Gjonaj për disa lokalitete ku ka me pas investime, mos të harrojmë ne kemi tre katër kontrata të mëdhaja që janë të parapame këtu në këtë kornizë që janë kontrata kornizë në disa raste janë të pa specifikuar se ku, po normal që ato parashihen me shtru asfalt me bë kanalizim me bë kubza sipas kërkesave dhe nevojave. Pse po them është dokument orientues, se dokumenti detal është buxheti, kur e votojmë në shtator kur t'i vjen koha dhe deri atëherë kemi kohë, kjo është një hap për me i fillu diskutimet, debatet me qytetarët, me organizatat edhe me e finalizu dokumentin, domethënë ky mund me pësu ndryshime. Tjetra e tha Dafina që ka dallime mes drejtorive të PDK-së dhe LDK-së, nuk ka në komunë drejtori as PDK-së as LDK-së, ka drejtori të komunës, e para dhe e dyta, edhe ky dokument është bërë në koordinim të plotë me secilin drejtor edhe të PDK-së, edhe të LDK-së edhe të KDTP-së edhe të Vakaitit edhe secilit që ka marrë përgjegjësi me implementu dokumentin që e kemi përpara, edhe vetëm për ilustrim, shëndetësinë e udhëheq LDK-ja, i ka 1.5 milion euro buxhet, turizmin e udhëheq PDK-ja, e ka 200 mijë euro buxhet, mirëqenia sociale e udhëheq LDK-ja e ka 500 mijë euro buxhet, administratën e udhëheq PDK-ja ka 275 mijë euro buxhet, domethënë nuk bëhen kesi farë dallimesh, po këto vijnë në raport me nevojat që kanë drejtoritë brenda vetes, asnjëherë nuk e kemi trajtu asnjë drejtor në baza partiake me së cilin komunikojmë bashkë kështu sikur me qenë krejt PDK-së. Sepse ne nuk jemi këtu me realizu objektiva partiake, po me i realizu nevojat që kanë qytetarët e Prizrenit. Edhe krejt në fund kishte me qenë fat i madh nëse ne arrijmë me realizu të paktën një pjesë të këtij dokumenti, e tha La Shuk vetëm vitin e aktual përmbaruesi i ka marrë para, jo jo prej 2022-ës pa u ndalë, po tash mundem

me ti dhënë me shifra, në 2025-ën dhe 2026-ën është kulmi i rasteve përmbartimore, sidomos në 2025-ën është pothuajse komplet kontrata kolektive, në 2026 ka edhe projekte që kanë mbet pa u paguar viteve të kaluara. Prandaj ne duhet krejt e kam thënë edhe seancë, me u çuar i madh e i vogël në këmbë me pshtu komunën, se është në krizë të madhe buxhetore. Normal që këtu ka edhe emër edhe mbiemër, qysh ka ardhur kjo gjendje, po nuk kemi nevojë me diskutu ato tema, e rëndësishme është qysh me mund ne me i kry të paktën disa projekte që janë të nevojshme, e ato janë shërbimet shëndetësore që mos me lënë QKMF-n edhe ambulancat pa pajisje medicinale, shkollat mos me i lënë pa rrymë, pa shërbime, se vitin e kaluar jemi rreziku dhe me ndërprerë rrymën, domethënë kemi pas problem në fund të vitit me i pagu dhe fakturat e energjisë elektrike prandaj fokusi duhet me qenë këtu e jo te pengesat, sepse në fund të fundit sa ka përgjegjësi kryetari i komunës, ekzekutivi komunal, ka përgjegjësi edhe kuvendi sidomos te miratimi i buxhetit është dokument që e ka përgjegjësinë kuvendi. Po jemi herët me fol bashë për projekte kështu konkrete, edhe Gjtonaj e kemi këtu, edhe secilin fshat edhe Kojushi nëse ka nevojë, edhe secili fshat se kemi kontratë 800.000€ për shtrim të rrugëve e cila mund të bëhet aty ku ka nevoja pak më urgjente, unë po pajtona me Lan Shukë që e tha dhe Arianiti prerja e rrugës, përnime është problem jo vetëm te rruga Nashecit po shumë rrugë që po ndodh po tash duhet me pranë, Prizreni është në atë lugën e ndërtimeve dhe fatkeqësisht para se me u pajis me leje për ndërtim, investitori shkon e merr në pëlqim në hidroregjion, hidroregjioni pa dal në vend ngjarje ja lëshon pëlqimin, Kedsa pa dal në vend ngjarje ja lëshon pëlqimin edhe kur të vjen koha e merr lejen edhe ti je obliguar me leju atë me e pre rrugën për me u kyç se ai nuk mund me i lënë 2.000 banorë pa i kryç kanalizim në rrymë. Pajtona që s'është hiç e mirë, megjithatë ne prapë e kemi menaxhuar mirë, se tash investitori jemi duke e shty me kthy në gjendjen e mëparshme dhe e kemi ndaluar që tash së fundi para një jave dy veprime në rrugë të Nashecit që kanë dash me e bë në mënyrë ilegale.

Shukri Quni (BDP): E ka bë të shtunën atë, ju e keni ndërprer të hënë atë deri të premten.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Po të tregoj që jemi goxha edhe në hall me ta, po nuk janë të gjitha pasojat prej veprimeve të Komunës janë edhe prej kompanive që janë të përfshirë në këtë procesin e lejeve, se ata paraprakisht i lejnë do pëlqime me të cilat ja lejon kyçjen në kanalizim, ja lejon kyçjen në shtyllat e energjisë elektrike dhe ato tani po kanë pasojat për të cilat po diskutojmë që një kohë të gjatë edhe njëherë si fund po mendoj që jemi herët me fol bash konkretisht për projektin, po duhet me bë që mos të pamundurën me ndihmu komunën me fillu të paktën në vitin 2027 me kriju një stabilitet nga fundi i vitit se deri atëherë ka me qenë përbes telashe dhe 1 milion e gjys janë tu prit me marrë tash mund me prit mas nja dy tre javëve të tjera. Kështu që telashet sikur me i pas do pare La Shuk në gjirollogari me t'i marrë nesër e ti ke pas me shku me e ble një pastërm, me çka e blenë domethënë është i njëjtë sikur këto projektet që i kemi këtu nëse mjetet s'i kemi në llogari. Për sa i përket nënave lehona drejtori ka thënë që nëse do të ketë mjete do të vazhdojmë, po qysh po shihet ka me pas telashe megjithëse ne jemi te bë të pamundurën që ato edhe sivjet me përfitu prej projekteve që i kemi paraparë dhe me rregullore bashkarisht.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, po veç me radhë fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Do t'i përgjigjja Kujtimit. Kujtim ti flet po në fund thotë livadhin e madh lema mua, fjalët i ke të ëmbla i ke të mira po i ke edhe me thënë më shumë me spec, fjala që përdore nuk dite me fol, unë Dafinës edhe kur e kam pas tash jemi në opozitë bashkë kur jam kanë pozitë kjo ka qenë opozitë ja kamë marrë lakmi në fjalë që i ka. Nuk është mirë që dikush kur flet me i thënë nuk dite me fol, vallahi po di me folë.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Si thash unë.

Shukri Quni (BDP): Më fal mua mu duk që thaje ashtu.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Thashë u nxita prej fjalimit të Dafinës.

Shukri Quni (BDP): U krye se unë i kam kërkuar asambleistit në mbledhje e ardhshme jo atë ditë, ju gjujta në qafë mu duk se ka thënë ashtu, por ai aq i bindur saqë tha nëse unë kam thënë kështu qysh po thu ti la Shuk, unë tha nuk vij më në kuvend edhe mua më erdhë keq shumë kam shku kam shfletuar procesverbalet, jo në atë mbledhje po ku ta di kur kish folur, e unë atë ditë erdhi momenti me ja thënë. Edhe ai zotnia nuk kish thënë ashtu qysh tash unë, ti s'ke qenë atëherë ka qenë Hazizi po edhe Kujtimi, unë i kam kërku falje atij personit, më fal se kam gabuar ... unë kur të gaboj edhe e lëdoj një njeri pa qëllim une i them më fal. A kur e kam drejt vallahi nuk ka kush që më qet në gjunj ai ndoshta kur është i fuqishëm po... Pastaj nënkryetar tha projektet janë bërë sipas kërkesave dhe nevojave qytetare, vallahi me kërkesa sot ja kam qu Ymranës një thes kërkesa se po më reklamohet po del aty në Komunë e dorëzova një kërkesën, e ne qka jemi duke bërë.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Po besoj që këtu janë edhe ato se këtu i marrin ata s'kanë ku me i marrë.

Shukri Quni (BDP): Po i kam çu edhe unë, krejt i kam protokoluar asnjë hiç nuk ka hy që kam bërë unë kërkesën. Pastaj domethënë për shkak të përmbaruesit nëse mundemi me i përmbyll gjysmën e këtyre projekteve, atëherë nuk është mirë atëherë ne edhe me këto me dal në kuvend.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Po ne duhet me orientuar dikah, hajde që po ndodh më e mira po e kemi stabilitet vitin e ardhshëm realizohet, me këtë trend ka me qenë problem, tash vetëm nëse duash e mshelim Komunën.

Shukri Quni (BDP): Jo Komuna nuk mshellet, kqyre ma optimis se unë as ti sje. Kur ti ke qenë nxënës i shkollës, unë këtu kam punu pa asnjë cent 10 vjet edhe jam kanë optimist që ka me ardhë një ditë e mirë, unë jam optimist edhe këto tre vjet që ju kanë mbetë juve unë jam optimist që kanë me ardhur më mirë kanë me ardhur mas tre vjetëve që keni me kalu ju. Ishallah mbushi mend se për ato katër vite kur i kam dhënë unë vërejtje atij shokut tim atje që sot e ka mshel me facebook e me telefon e me krejt. Po unë i kam dhënë vërejtjet në mënyrë shoqërore o Qel mbaja mendjen se shumë je tu shku hava, i kam pasur letra të çel me të, shokë të shkollës mesme e kam pas tash s'po di çfarë me thënë tjetër send edhe me më pas rëndu ai nuk isha idhnu se e kam pas shok.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë atëherë që nuk kemi diskutime të tjera, po Ilir.

Ilir Gashi (LVV): Zyrtari i drejtorisë tha që deri tash diku 15 milion euro janë pagu obligime, nënkryetari tha 1 milion tash shpejt na i marrin, mbas kësaj prapë presim. A kemi një parashikim të qartë se sa borxhe i kemi, sa obligime kemi edhe a është një planifikim kur mendohen këto krejt të gjitha me u likuiduar me u realizu dhe kur mund me u kthi pastaj normalitetit me buxhet? Edhe çështja e dytë edhe pse nënkryetari tha këto janë vetëm si orientim, jo projekte konkrete, ishte paraparë asfaltimi i rrugës për në Kopanavod, a është nga ana e Novosellës apo e Skorobishtit, nëse është nga ana e Novosellës, është një huçje totale, është shtegu i ecjes andej edhe degradimi i natyrës bëhet sikurse që është bërë edhe me hapjen e disa rrugëve të tjera më herët, e kjo edhe nëse asfaltohet atëherë më Kopanavoda për bjeshkatar më përfundon definitivisht, po nëse bëhet rruga nga ana e Skorobishtit atëherë është ndryshe muhabeti.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): A po shkruan asfaltim?

Ilir Gashi (LVV): Po asfaltim.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Është projekt me bashkëfinancim me ministrin e Rasim Demirit po e trajtoj, se nuk e di.

Ilir Gashi (LVV): Sa i përket borxhit a kemi një projeksion ku jemi?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po atëherë fjala prej ju.

Lulzim Sylejmani: Se disa prej përgjigjeve i dha edhe nënkryetari po disa të tjera po i jap unë sa i përket la Shuk javës Remzi Ademit, nuk është bë pse ka ndërhyrë nënkryetari po për shkak se buxheti i drejtorisë së arsimit për prill dhe për maj është ekzekutuar nga përmbaruesi 400.000 euro dhe ne kemi kërkuar buxhetin sipas keshplanit që e kemi pas për qershor, i kemi kërkuar ministrisë bina qetash ta shfrytëzojmë dhe mjetet ne i kemi lokuar të qershorit paraprakisht dhe kemi filluar procedura, se nuk ka qenë çështje që e ka neglizhuar dikush ose ka qenë komplet çështje e financave të drejtorisë së arsimit. Sa i përket kontratës kolektive, mendoj që përafërsisht i ka ardhë fundi po nuk jemi ne i dimë lëndët veç që i kemi në në proces po nuk i dimë lëndët që i kanë avokatë që janë nëpër gjykata edhe që i kanë përmbaruesit, ato nuk mund me dit edhe sa është vlera, por zakonisht tash po vijnë vlera më të vogla, po vijnë kamatat ndëshkuese që s'janë paguar me kohë, po vijnë disa proçese, po vijnë inflacion, për shembull sa ka mujt me qenë fuqia e vlerës atëherë që s'ma keni paguar, sa mujm domethënë janë vlera më të vogla, po mendoj që kontrata kolektive sa i përket Prizrenit ka ardhur diku me ekzekutu te 80%, por 20% që është hala nëpër duart të përmbaruesve të avokatëve, domethënë tash sa është ajo vlerë ne nuk e dimë sepse është terren, ndoshta dikush ka kërkuar me ju paguar kamata ndiku ndëshkuese, dikush s'ka kërkuar, nuk e dimë sa është ajo.

Haziz Hodaj (LDK): Më fal vetëm diçka, këto që janë janë marrë, a e dini sa janë kontrata kolektive, sa janë borxhet tuaja.

Lulzim Sylejmani: Po i dimë të gjitha, sepse raportet financiare që i kemi përgadit, tremujor, vjetor domethënë pasqyrat financiare të gjitha janë të cekura dhe janë të publikuara.

Haziz Hodaj (LDK): Domethënë që kontratat kolektive janë ato s'mundesh me i evitu për këto borxhet i keni fajet vet.

Lulzim Sylejmani: Tani po të flas unë kështu domethënë në cilësinë e letrave që i ka simfk-ja sistemi jo na domethënë që i ka sistemi i financave që menaxhon ministria, domethënë prej atyre 35-36 milion euro që janë ekzekutuar 70% kanë qenë të kontratës kolektive dhe pjesa tjetër është e projekteve kapitale kontratave që i ka lidhur komuna, por jo si pasojë e një buxhetimi të keq që ka bë komuna për ato, por nëse në vitin 2022 prej kontratës kolektive janë marrë prej kapitalve 2 milion, qata operatorë e kanë dërguar në vitin 2023, nëse ju kanë marrë kapitalet në vitin 2023, e kemi dërguar në vitin 2024, në vitin 2026 tash që po flasim, prej atyre 15 milionve që janë ekzekutuar, diku gjysmë përgjys janë, gjysë janë kapitale e atyre 13 milionve që janë ekzekutuar vitin e kaluar, domethënë ky zinxhiri nuk do të thotë sepse ne jemi përballë me auditorin e jashtëm domethënë që ka shkruar aty një paragraf që ka thënë nuk është planifikuar mirë dhe komuna ka raportu obligime, na vitin e kaluar i kemi marrë 12.3 milion janë ekzekutuar 12.3 milion, ndërsa si fatura të papaguame ne kemi raportuar 9.5. Sikur ti kishim pas ato që mos me i pas marrë ata ne në fund të vitit ishin qenë shumë komod ishim qenë pa obligime pa asnjë fakturë në pritje dhe tashti ajo pasojë po reflekton edhe këtë buxhetin se të përgatitim sot. Domethënë e çrregullon komplet dhe unë si analist i buxhetit, nëse ka dikush më ekspert që në këtë situatë financiare që është kriju me bë një zgjidhje më të mirë sesa ky që e kemi bë, unë jam me juve 24 orë veç hajde ta bëjmë më të mirën prej kësaj.

Haziz Hodaj (LDK): Jo ne nuk po dyshojmë në ekspertizën tënde as në përvojën as në profesionin, po unë shkurt po ju them shtrini këmbët sa e keni jorganin e parashihni projektet që mundeni me i realizu përafërsisht.

Lulzim Sylejmani: Është ajo që ne nuk po mudem shumë me përfshi projekte të reja, sepse s'ka hapësirë. Shumica e projekteve të cilat janë paraparë këtu si projekte të reja, fillojnë me buxhetu në vitin 2028, 29, a e di pse, sepse ne kur ta përgatitim kornizën, domethënë nuk mund me përgatit buxhet veç për 2027, duhet me parashiku edhe ato kapitale në vitin 2028-2029, sepse janë limitet që na duhet me i aprovu.

Dafina Alishani (LVV): Më fal veç pak, pse po na dezinformon kështu, projekti i ri janë te drejtoria e shërbimeve publike, një, dy, tre, katër, pesë, të cilat janë planifiku vitin që po vjen.

Lulzim Sylejmani: Unë nuk thashë të gjitha.

Dafina Alishani (LVV): Ju thatë të gjitha, të tjerat po i shikoj projekti i ri ndërtimi i komplekseve memoriale në komunën e Prizrenit, projekt i ri 100.000€.

Lulzim Sylejmani: Ti e ngrite që ka projekte që janë zero në vitin 2027.

Dafina Alishani (LVV): Ju po thoni që tash ne e kemi për obligim me i planifiku tre vitet e ardhshme, po vitin e parë nuk kemi planifikim të projektet e reja.

Lulzim Sylejmani: Nuk thash të gjithë, ti e përmende ki projekte me zero.

Dafina Alishani (LVV): Projektet e reja unë i kam numëruar sa janë total, prej këtyre të rejave ju keni planifikuar edhe në vitin e parë, 50.000, 90.000, 100.000, 86.000, a din? mua shumë po më vjen keq me një tabelë që edhe unë po e lexoj, po mundeni kaq haptas me na thënë fjalë jo të vërteta.

Lulzim Sylejmani: Dëgjoni, për secilin projekt të ri që është i buxhetuar vitin 2027, drejtorët janë në kuvend edhe ju përgjigjen drejtorët për secilin dikaster, drejtori domethënë unë nuk mund me ju përgjigjë, po për atë që the e ka projekte me zero në 2027, përgjigja ime është për shkak se drejtori të caktuara e kanë për obligim limitet për vitin 2028-2029 me i plotësu.

Dafina Alishani (LVV): Po pse me shtu projekte të reja kur ne me buxhet jemi keq, ne kemi borxhe, ne kemi përmbarues, pse ne nuk mundemi qysh tha qatë jorgan, pse ne po e zgjasim hala jorganin.

Lulzim Sylejmani: E nderuar Dafinë, ne kemi kërkuar nga ministria me buxhetuar kontratën kolektive që sa vjet.

Dafina Alishani (LVV): Leje me ministrinë, ministria e keqe sipas juve, leje, ju e keni buxhetin 78 milion, i keni borxhet edhe pak a shumë po mundeni me pas parasysh edhe 20% i përmbaruesit në rregull, pse ka projekte të reja, pse po i bëni lajthitje njerëzit me e votu një KAB për të cilën është e parealizueshme, unë këtë hall e kam.

Lulzim Sylejmani: Dafinë, unë po them kështu, sikur të na kishin lejuar ata me buxhetu ne obligimin se kishim qitë asnjë projekt të ri, e kishim buxhetu obligimin me një kod të posaçëm qysh ja kishin gjet emrin.

Dafina Alishani (LVV): Okej, a janë projektet e reja janë buxhetu, janë planifiku për me i pagu borxhet.

Lulzim Sylejmani: Ato limite prej 23 milion të kapitalet, domethënë prej 23 milionve, domethënë 21.8 gati 22 milion janë obligime kontraktuale të lidhura të cilat duhet me i përcjell dhe është 1.2 milion që mund të manovrojmë me kërkesat e qytetarëve si projekte të reja. Domethënë drejtoritë përkatëse nga dëgjimet publike që edhe këto propozime që kanë ardhur të reja, domethënë janë qenë prej kërkesave që janë ardhur që janë deponuar kërkesa të caktuara, po ndërkohë deri në shtator me dëgjimet publike dhe kërkesat e qytetarëve, këto projekte të reja ka mundësi me u lëviz, sepse pjesa tjetër është kontratë e lidhur, projektet e reja mund me lëviz varësisht prej kërkesave. E pata edhe një përgjigje prej juve sa i përket shëndetësisë, drejtori ka thënë që ne keq jemi te mallrat nuk jemi te pajisjet, domethënë te furnizimet me materiale shpenzuese për analiza për ato, sepse sivjet ju kanë ekzekutuar 1 milion euro, por thjesht domethënë ne jemi tu gjet edhe me të

hyrat vetanake edhe me të hyrat që i kanë po mendoj buxhetet nga mallarat që i kanë drejtori të tjera, po atë pjesë nuk mund me e ndërpre dhe me lënë pa furnizime. Domethënë është pyetje kategoria e mallrave dhe shëndetësisë mbi 1.5 milionve ja kemi bërë 1.9 milion kategoritë e mallrave për vitin e ardhshëm, domethënë është rrit për shkak se mundet në fund të vitit me na mbetë ndonjë obligim i këtij viti për punë që me realizuar pagesa vitin tjetër.

Dafina Alishani (LVV): Te parku ekonomik pse s'është planifikuar sivjet në 2027.

Lulzim Sylejmani: Përgjigje kanë drejtori përkatëse në kuvend.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë atëherë kalojmë në procesin e votimit.

Shukri Quni (BDP): Jo vetëm pak replikë se ma përgjigje unë nuk kërkova përgjigje prej juve, kërkova përgjigje prej nënkryetarit. Ju jeni zalli jeni aty në drejtori të ekonomisë, drejtorat janë ujë ata shkojnë ju mbeten aty, a vjen i PDK-së, a vjen i LDK-së a vjen i VV-së, kushdo qoftë që ka me ardhë në pushtet ju jeni që s'luni, mos ja mbani krahun partive hiç se këto shkojnë e vinë. Unë me 2 qershor 2026 e kam ngritur çështjen pse s'është mbajtur mbledhja se krejt çka flas mundohena me argumentu më në fundë bile nja 50% mos me qenë rren krejt 100% edhe e ngrita si çështje, unë e pata pse drejtorat nuk ishin këtu që me ata më kollaj këtu ju them disa drejtorë se aty po vjen shumë keq se me dalë prej taktit aty, s'ja vlenë as atij as mua atëherë. Drejtoresha e ke përgjigjen çfarë përgjigje më ka dhënë edhe ka dalë jashtë edhe atëherë unë kam reagu, u qu nënkryetar e dëgjove çfarë foli, me 8 domethënë se ka qenë 2 qershori, atëherë e patëm... festa ke 12 qershori që mbajtëm seancën me javën domethënë të hënë e 8 qershorit ka dalë në media që edhe nëpër shkollë që do të mbahet java Remzi Ademaj edhe menjëherë ka filluar me të 15-in, u mbajt u organizu e përfundoi e krejt as jam me i pa as me i kqyr me i uru as hiç s'më ka interesu edhe mos me mbajt hiç s'kam pas dert edhe se jam vet themelues e kam mbajt shtatë vjet e krejt. E qysh tash, mos kish fol nënkryetari s'ke duke u mbajtë hiç, unë tash bile foli më lirisht qysh u bë ky kur dult tha kam me u mbajt po edhe unë u reagoval menjëher.

Lulzim Sylejmani: Kam qenë prezent edhe po ta kthej përgjigjen domethënë profesionale drejtoria e arsimit ka pas...

Shukri Quni (BDP): Po pse s'tha ajo ka me u mbajtë zotri Quni .

Lulzim Sylejmani: Drejtoria e arsimit në mallra e shërbime i ka pas 1.2 milion edhe kur bëhet keshplani ministria e financave kërkon një keshplan qysh ty të vijnë mjetet çdo muaj, nuk t'i jep këtu 1.2 milion krejt me ti qit në janar dhe është keshplani dhe ka qenë keshplani nga 200.000 euro çdo muaj dhe mjetet për prill dhe maj te drejtoria e arsimit 400 mijë euro janë ekzekutuar nga përmbaruesi çka ka ndodhur se tashi më KRPP-ja prokurimi nuk mundet me lidh kontratë nëse s'ke mjete. Domethënë kanë filluar procedurat jenë marrë mjetet çfarë është dashur me bërë, është dashur me bërë ne mjetet e qershorit me i kërkuar që me na dhënë me bërë zotimin edhe me realizu kontrata, domethënë që ky proces e ka vonuar atë farë po mendoj që ka kaluar data rregull që a mbaj çdo vit, jo që s'ka dashur me u mbajt ose dikush që e ka peng, thjesht komplet ka qenë

çështje e mungesës së mjeteve për muajin adekuat. Përndryshe procedurat e prokurorit kanë filluar me kohë po kur janë ekzekutuar mjetet më kontratë s'mundesh me lidh pa pare as në mallra as në kapitale.

Dafina Alishani (LVV): Po bre, veç ky e ka një hall tjetër edhe unë po e di që po e kuptoni po po bëheni sikur s'po e kuptoni, njeri kur të fol për Remzi Ademaj baci Shukri duhet me pas respekt. Edhe jo me u çu me liru sallën e me thënë hajt se unë kam punë të tjera, a e din qasja është e gabueshme se njeriu të ka pyet me gjithë respektin edhe me ndjeshmërinë që e ka për rastin, e për luftëtarin e krejt. E nuk është në rregull me u çu me liru sallë para një njeriu që ka kontribuar shumë, këtë hall e ka, jo, unë e kam, se qasja ka qenë shumë e gabueshme e drejtoreshës.

Shukri Quni (BDP): Ajo shumë ka qenë e gabueshme, ajo ka mujt me thënë atë fjalë me thënë, kjo punë ka me u kryer. Unë publikisht i thashë, unë me ty privat nuk flas ti ske qare pa folë zyrtarisht me mua se të lidhë puna, sa herë ngres pyetje dhe ngres çështje, s'ka qare pa u përgjigjë drejtorat ose shkon në shtëpi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kalojmë në procesin e votimit, sa jemi prezent, 9 antarë jemi prezent të komitetit për politikë dhe financa. Sa jemi për, që pika e rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i kornizës afatmesme buxhetore KAB-i për vitet e 2027-2029 që t'i rekomandohet kuvendit për mbledhjen e nesërme që do të mbahet nga ora 10? 6 jemi pro. Kundër? 3 kundër. Abstenim nuk ka. Atëherë miratohet me gjashtë vota për që kjo pikë e rendit të ditës i rekomandohet kuvendit për mbledhjen e nesërme pra në datë 25 në ora 10 që do të mbahet në sallën e kuvendit komunal. Këtu e mbyllim pra këtë seancë, ju faleminderit për pjesëmarrjen.

Edhe t'ju njoftoj edhe për këtë mbledhje, është edhe një mbledhje e jashtëzakonshme, e kemi kërkesën e kryetarit këtu që kjo mbledhje është në një pikë të rendit të ditës, kjo nuk ka nevojë të merret rekomandimi prej komitetit për politikë dhe financa pasi është më së shumti e karakterit solem dhe në shumicën e rasteve këto nuk i nënshtrohen ligjshmërisë së ministrisë së administrimit të pushtetit lokal duhet të merret vendimi aty marrim mendimin e grupeve parlamentare.

Dafina Alishani (LVV): A do të mbahet fjalim nga shefat e grupeve?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po shefat e grupeve do ta japin mendimin e vetë apo fjalim si të dojnë aty po edhe partive të tjera që nuk janë të përfaqsuara.

Dafina Alishani (LVV): Fjalim apo deklaram në emër të grupit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Deklarim se a do ta mbështetni propozimin.

Arianit Berisha (PDK): A del propozuesi i pikës?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po propozuesi i pikës del një përmbledhje, e marrim mendimin e të gjithë shefave të grupit.

Dafina Alishani (LVV): Edhe një pyetje e kam kryesues seancë të rregull a do të kemi në këtë muaj a e keni mendu në fillim të muajit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ne ndoshta këtë seancën po nuk patëm pika prej drejtorive se na i kërkojmë prej drejtorive pikat e rendit të ditës do të ketë seancë të rregullt nga fundit po besoj edhe e dini të gjithë, në fillim të muajit korrik apo nvaret se si. Tash janë afatet ligjore e dini që ne e bëjmë kërkesën shtatë ditë duhet rendi i ditës t'i kqyrim ditët aty, po mendoj që maksimumi deri me 20 në qoftë se kemi kërkesë disa prej drejtorive.

Dafina Alishani (LVV): A nuk kemi kërkesa?

Simir Krasniqi (Kryesues): Për momentin nuk ka.

Dafina Alishani (LVV): Një pikë që duhet me diskutuhet që është klasuar është raporti auditorit të jashtëm, ka dalë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Tash janë drejtoritë është raporti i jashtëm i auditorit, ne e kemi planin e Kuvendit, planin e punës së Kuvendit që e kemi votuar bashkarisht.

Dafina Alishani (LVV): Mua po më duhet me ditë se njerëzit po shkojnë dy ditë tre ditë pushim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina ne i përmbahemi planit të punës së Kuvendit edhe kërkesat që vijnë. Faleminderit për pjesëmarrje shihemi nesër në seancë.

Mbledhja e KPF-së, përfundoi në ora 11:20.

